

**Përmbledhje jo teknike**  
**L71614507K**

**Subjekti “ONI LLAPRI” P.F**

**NUIS: L71614507K**

**PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE PËR**  
**AKTIVITETIN:**

**“VEPRIMTARI TË TJERA QË PËRFSHIJNË PËRDORIMIN E**  
**SOLVENTËVE”**

<b>ID 7.12/g</b>	<b>Lyerja dhe lustrimi i makinave</b>
------------------	---------------------------------------

Sipas shtojcës 1 të ligjit Nr.10448 datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 52/2020 datë 30.04.2020 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10448 datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar

**VENDNDODHJA:**

**Qarku Durrës, Bashkia Shijak, Njësia Administrative Xhafzotaj, objekt me Nr. Pasurie**  
**25/219, Zona Kadastrale 2574**

**Përmbledhje jo teknike**  
**L71614507K**

**PËRMBAJTJA E RAPORTIT**

**1. PROFILI OPERATORIT**

**2. QËLLIMI I RAPORTIT**

**3. OBJEKTIVA E RAPORTIT**

**4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT**

**5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT**

**5.1. MENAXHIMI I INSTALIMIT**

**5.2. LËNDËT E PARA**

**6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË  
MJEDIS**

**7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS**

**8. MONITORIMI**

# Përmbledhje jo teknike

## L71614507K

### 1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti “Oni Llapri” p.f është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB në formë ligjore si Person Fizik i pajisur me NUIS: L71614507K me përfaqësues Z. Oni Llapri

Fusha e veprimtarisë së operatorit konsiston në:

- Servis Lyerje e makinave

### 2. QËLLIMI I RAPORTIT

Subjekti paraqet këtë raport, sepse kërkon të aplikojë më pas për t’u pajisur me leje mjedisi Kod III.1.B Leje Mjedisit Tipi B për aktivitetin:

**ID 7.12/g Lyerja dhe Lustrimi i makinave (kapaciteti të gjitha instalimet” e cila klasifikohet si Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve.**

### 3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT

- Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis (emetimet në ajër, gjenerimi i zhurmave; Ndikimi në florë/faunë, Mbetje të gjeneruara, Ndikimi Social – Ekonomik; Ndikimi në cilësinë e jetës në qendrat e banuara; Ndikim në peisazhin e zones)
- Gjetja e alternativave që janë miqësore me mjedisin dhe propozimi i masave të duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative gjatë zbatimit të aktivitetit(veprimtarisë).
- Lehtësimi i informimit të publikut dhe organeve vendim marrëse mjedisore lidhur me zbatimin e aktivitetit(veprimtarisë).

### 4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT (VEPRIMTARIË)

Aktiviteti (veprimtaria) do të zhvillohet në adresën: Qarku Durrës, Bashkia Shijak, Njësia Administrative Xhafzotaj, objekt me Nr. Pasurie 25/219, Zona Kadastrale 2574.

Zona e përzgjedhur për zhvillimin e kësaj veprimtarie është e përshtatshme për këtë lloj aktivitetit duke marrë parasysh përparësitë si:

- Furnizimi me ujë
- Furnizimi me energji elektrike

## Përmbledhje jo teknike L71614507K

- Lehtësi në aksesin në rrugë të mjeteve të transportit (ambulancë, zjarrfikës, mjete furnizuese)



**Koordinata e veprimtarisë së lysterje dhe lustrimi i makines sipas tabelës me poshte:**

<b>E:</b>	<b>4377154.20</b>
-----------	-------------------

<b>N:</b>	<b>4579377.10</b>
-----------	-------------------

## Përmbledhje jo teknike L71614507K

### 5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT:

Aktiviteti (veprimtaria) e subjektit është lyerje e automjeteve

Në këtë instalim zhvillohet një veprimtari e specializuar në lyerjen dhe riparimin estetik të automjeteve. Shërbimet kryesore që ofrohen janë:

- Përgatitja e sipërfaqeve për lyerje, përfshirë pastrimin, heqjen e bojës së vjetër, zbutjen e sipërfaqeve dhe aplikimin e bazave mbrojtëse kundër korrozionit.
- Lyerjen e automjeteve me bojë profesionale (bojë me bazë uji apo solventi)
- Përzierjen dhe përgatitjen e ngjyrave sipas specifikave të klientit ose ngjyrës origjinale të mjetit.
- Lustrimin përfundimtar dhe aplikimin e shtresave mbrojtëse kundër rrezeve UV dhe faktorëve atmosferikë.
- Rregullime të vogla të karrocërisë dhe përmirësime estetike sipas kërkesave të klientëve.

Veprimtaria do të zhvillohet në përputhje me standartet teknik dhe rregulloret e mbrojtjes së mjedisit, duke përdorur materiale të miratuara dhe teknologji bashkëkohore për minimizimin e ndotjes apo dhe mbetjeve të rrezikshme (ky biznes nuk gjeneron të tilla).

### PËRSHKRIMI I INSTALIMIT

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin në fjalë.

Për zhvillimin e aktivitetit operatori operon konform të gjitha rregullave teknike, tatimore fiskale dhe atyre mjedisore.

Puna është e organizuar në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organograme, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësitë e secilit të punësuar. Kjo metodë është efektive për realizimin sa më eficient dhe të suksesshëm të punës.

Pak a shumë hierarkia dhe rrjedha e autoritetit, ku çdo gjë varet drejtëpërdrejtë nga drejtuesi i kompanisë (subjektit person fizik)

## Përmbledhje jo teknike L71614507K

### Fuqia punëtore

Në pikën e zhvillimit të aktivitetit janë të punësuar 5 individë. Subjekti ka pajisur të gjithë të punësuarit me uniforma pune dhe mjete mbrojtëse. Punonjësit do të trajnohen lidhur me zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë, MNZSH si dhe mbrojtjen e mjedisit në ambientet e punës dhe atij përreth.

Për shmangien e aksidenteve nga pajisjen tregohet një kujdes i veçantë nga punonjësit për mirëmbajtjen e gjendjes së tyre teknike si dhe zbaton me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik.

\*\*\* Mbrojtja e shëndetit dhe siguria në punë janë në qendër të vëmendjes së operatorit.

Tabela e mëposhtme jep një informacion mbi kushtet e punës:

KUSHTET E PUNES					
<b>Numri total i punonjësve</b>	<b>7</b>				
<b>Shpërndarja e punonjësve</b>	<b>Zyra</b>	<b>Shërbim</b>	<b>Mirëmbajtje</b>	<b>Magazinimi</b>	<b>Të tjera</b>
	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
<b>Turnet dhe aktivitetet</b>	<b>Zyrat / Administrata</b>		<b>Instalimet</b>		
	<b>1 TURN</b>		<b>1 TURN</b>		
<b>Orët e punës</b>	<b>08:00 – 17:00 8 orë (1 orë pushim)</b>		<b>08:00 – 17:00 8 orë (1 orë pushim)</b>		
<b>Numri i ditëve të punës në vit</b>	<b>261</b>				
<b>Numri i orëve në vit</b>	<b>2088</b>				
<b>Variacionet sezonale</b>	<b>Nuk preket nga variacione sezonale</b>				

### 5.2 LËNDËT E PARA DHE NDIHMËSE

Aktiviteti është një aktivitet i mirëfilltë prodhimi, prandaj mund të flasim për lëndë të para për veprimtartinë.

Sipas tabelës së mëposhtme janë listuar lëndë të para dhe lëndë/materiale ndihmëse që subjekti do të përdorë në funksion apo zhvillimin e aktivitetit.

Lëndë të para	Lëndë / materiale ndihmëse
Bojë me bazë uji	Letër smerile (rërëzim)
Bojë me bazë solventi	Shirit maskues
Primer (bazë ngjitëse)	Plastikë mbrojtës (celofan)
Filler (mbushës)	Pëlhurë (papier fshirje)

## Përmbledhje jo teknike L71614507K

Hardener (përforcues)	Pistoletë spërkatëse (spray gun)
Llak (clear coat)	Kompresor ajri
Hollues (thinner)	Filtra ajri
Solvent pastrues	Disqe për lustrim
degresant	Pasta për lustrim
	Pajisje matëse ngjyre

### Lëndë të para.

Lëndët e para sigurohen nga furnitorë në bazë të porosisë që porositësi do të kryejë. Ato do të sillen në ambientet e subjektit me anë të automjeteve të furnitorëve për këtë qëllim për tu futurë me pas në pjesën magazinuese të lëndëve të para.

### Lëndë / materiale ndihmëse

Lëndët ndihmëse përdoren për të përmirësuar cilësinë, funksionalitetin, si dhe për të lehtësuar procesin e punës.

## 6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS.

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm. Kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin, tipin e veprimtarisë, e cila mund të ketë impact të drejtëpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar të pranueshëm.

### RREZATIM JONIZUES:

\*\*\*Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë rrezatime jonizuese, pasi vetë natyra e aktivitetit nuk shoqërohet me ndikime të tilla

### VIBRACIONE:

\*\*\*Zhvillimi i aktivitetit nuk do të shoqërohet me vibrime gjatë proceseve të punës. Edhe nëse do të ketë do të jenë në harqe kohe të shkurtra vetëm kur punojnë pajisjet ndihmëse për të kryer mirëmbajtjen.

### NDIKIMET NE POPULLSI:

\*\*\* *Aktiviteti do të zhvillohet në një zonë urbane. Aktiviteti sipas klasifikimit nuk do të shoqërohet me ndikime negative në popullsi. Madje ky aktivitet është*

## Përmbledhje jo teknike L71614507K

*një e mire publike, e cila do t'i shërbejë komunitetit të zonës në aspektin e punësimit. Operimi i mëtejshëm i aktivitetit nuk pritet të ketë ndikime negative në popullsinë e zonës që banon në afërsi të subjektit, gjithashtu edhe në bizneset e tjera që ndodhen pranë.*

### NDIKIMET NE KLIME

\*\*\*Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperature, në drejtim të erës, dhe sasinë e rreshjeve. Pra kryerja e kësaj veprimtarie nuk ndikon aspak në kushtet klimaterike të kësaj zone.

### NDIKIMDG NGA ZHURMAT

\*\*\* Ushtrimi i këtij aktiviteti do të shoqërohet me gjenerim zhurme të shkaktuar nga lëvizja e mjeteve të transportit. Duke qenë se aktiviteti do të ushtrohet në afërsi të një rruge ku lëvizja e mjeteve do të jetë gjatë gjithë kohës prezente, atëherë: zhurmat e gjeneruara nga aktiviteti janë të papërfillshme. Kështu vlen të theksohet se gjenerimi i zhurmave do të jetë momental gjatë proceseve.

### NDIKIMI NE AJER

\*\*\* Ushtrimi i këtij aktiviteti do të shoqërohet me shkarkime në ajër të gazeve të ndryshme si CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, Grimcat PM<sub>10</sub>, PM<sub>2.5</sub>

### NDIKIMET NE UJERA.

\*\*\* Zona ku ushtrohet aktiviteti nuk përfshihet mbi ndonjë pellg ujëmbledhës. Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti është i pozicionuar në distance relativisht të largëta nga burimt ajrore.



## Përmbledhje jo teknike L71614507K

### BAZA LIGJORE

- ◆ LIGJI NR 10 431, DATE 9.6.2011 “PER MBROJTJEN E MJEDISIT”
- ◆ LIGJI NR 10 440,DATE. 7.7.2011 “PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS” DHE NDRYSHIMET E TIJ.
- ◆ LIGJI NR. 10 448, DATE 14.07.2011 “PER LEJET E MJEDISIT
- ◆ LIGJI NR. 9115,DATE. 24.07.2003 “PER TRAJTIMIN MJEDISOR TE UJERAVE TE NDOTUR”
- ◆ LIGJI NR. 9537,DATE. 18.05.2006 “PER ADMINISTRIMIN E MBETJEVE TE RREZIKSHME”
- ◆ LIGJI 9587 DATE 20.07.2006 “PER MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT”
- ◆ LIGJI NR. 10463, DATE 22.09.2011 “ PER MENAXHIMIN E INTEGRUAR TE MBETJEVE”
- ◆ V.K.M NR. 1189 DATE 18.11.2009 “PER RREGULLAT DHE PROCEDURAT PER HARTIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMIT KOMBETAR TE MONITORIMIT TE MJEDISIT”
- ◆ VKM NR. 402, DATË 30.6.2021 “PER MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TE KLASIFIKIMIT TE MBETJEVE”.
- ◆ VKM NR.435,DATE.12.09.2002“PER NORMAT E SHKARKIMEVE NE AJER NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”
- ◆ VKM NR.103, DATE. 31.03.2003 “PER MONITORIMIN E MJEDISIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”
- ◆ VKM 435, DATE 12/09/2002 "PER MIRATIMIN E NORMAVE TE SHKARKIMIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE".
- ◆ UDHEZIMI NR.8, DATE 27.11.2007 “PER NIVELET KUFI TE ZHURMAVE NE MJEDISE TE CAKTUARA”
- ◆ VKM 177, DATE 31/03/2005 "PER NORMAT E LEJUARA TE SHKARKIMEVE TE LENGETA DHE KRITERET E ZONIMIT TE MJEDISEVE UJORE PRITese".
- ◆ LIGJI NR. 10 433, DATE 16.06.2011 “ PER INSPEKTIMIN NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”
- ◆ LIGJI NR. 10279 , DATE 20.05.2010 “PER KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE”
- ◆ LIGJI NR. 9824, DATE 1.11.2007 “PER AKREDITIMIN E ORGANIZMAVE TE VLERSIMIT TE KONFORMITETIT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”

## Përmbledhje jo teknike L71614507K

Ndikimet në mjedis ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi: - ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.

Konkluzione në materialin e mësipërm shihet se ka një ndikim minimal, por gjithsesi subjekti “servis sharka” është i ndërgjegjshëm se sado minimal ky ndikim duhet të mirë-menaxhohet dhe të bëhen përpjekje teknike për të bërë këtë ndikim me vlerë zero. Aktiviteti konsiderohet i përshtatshëm dhe i pranueshëm në zonën e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore për zonën përreth. Subjekti “Oni Llapri” do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë cdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone

Konform të gjitha akteve dhe procedurave ligjore në fuqi i drejtohem aplikimit për ndjekjen e procedurës konsultimit me publikun dhe palet e interesuara për aplikimin për leje mjedisi të tipit b: “lyerja dhe lustrimi i makinave” id 7.12 G. Lyerja dhe lustrimi i makinave. Kapaciteti kufi për lejet e tipit b: të gjitha instalimet.



KËRKUESI:

Oni Llapri